



Prishtinë: 18.07.2012

Kodi i ZRRE-së: V_428_2012

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2,14 dhe nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 03/L-185;
- Nenin 18 të Rregullës mbi Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Kërkesën për Kontestin e ngritur nga KOSTT SH.A. ndaj KEK SH.A. për çështjen: Refuzimin e pagesës për shërbimet e transmisionit dhe kthimin e faturave për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor të vitit 2011; dhe
- Dëshmitë e paraqitura nga palët,

në seancën e mbajtur me datë 18.07.2012, nxori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET** kërkesa e KOSTT-it dhe obligohet KEK-u t'i paguaj KOSTT-it faturat për periudhën tetor, nëntor dhe dhjetor të vitit 2011 në vlerë prej 3,802,949€.
- II. OBLIGOHET** KOSTT-i t'i paguaj KEK-ut për blerjen e energjisë për mbulimin e humbjeve në transmision sipas vlerës së faturuar.
- III. OBLIGOHET** KEK-u t'i paguajë KOSTT-it kamatën ligjore vjetore prej 8% në vlerën e borxhit për vonesat në faturat e papaguara nga KEK-u.
- IV. OBLIGOHET** KOSTT-i t'i paguaj KEK-ut kamatën ligjore vjetore prej 8% në vlerën e borxhit për blerjen e energjisë për mbulimin e humbjeve në transmision sipas vlerës së faturuar.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 28.03.2012 ka pranuar nga KOSTT-i kërkesën për iniciimin e kontestit kundër KEK Sh.A lidhur me:

Refuzimin e pagesës për shërbimet e transmisionit dhe kthimin e faturave për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor të vitit 2011.

Mosmarrëveshjet në mes të KOSTT-it dhe KEK-ut kanë filluar me shkresat e shkëmbyera nga ana e KEK-ut, të datave 14 nëntor 2011, 14 dhjetor 2011 dhe 20 janar 2012 në të cilat KEK-u refuzon të kryej pagesën e faturave për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor të vitit 2011, për shërbimet e shfrytëzimit të rrjetit të transmisionit, dhe shkresat e KOSTT-it të datës 17 nëntor 2011 dhe 24 nëntor 2011.



Kontesti në ZRRE është ngritur nga KOSTT-i me datë 28 mars 2012. Pas kësaj date, si reagim ndaj kontestit të ngritur nga KOSTT-i, KEK-u ka dërguar përgjigjen me datë 29 maj 2012 ndaj inicimit të kontestit nga KOSTT-i në ZRRE.

Me datë 14.11.2011 KEK-u i ka dërguar KOSTT-it një shkresë lidhur me faturat e ngarkesave të transmisionit për tetor 2011. Në këtë shkresë KEK-u ka theksuar se: *“Për nëntë muajt e parë të vitit 2011, faturimi neto nga KOSTT për KEK-un ishte 8,652.175.68€, një shumë vetëm 21,824.32€ më e ulët se të Hyrat Tavan”. Më tej në shkresë citohet marrëveshja për kycje: “Ngarkesat e SHST-së duhet, që në çdo kohë, të llogariten në përputhje me tarifat dhe praktikat rregullatore dhe vendimet e aprovuara nga ZRRE-ja.*

Provë: Shkresa e KEK-ut dërguar KOSTT-it me datë 14.11.2011

Me datë 17.11.2011 KOSTT-i i ka dërguar një shkresë KEK-ut lidhur me faturimin ngarkesave të transmisionit për muajin tetor 2011. Në shkresë është theksuar se: *“Në letrën e dërguar nga KEK-sha të datës 14.11.2011 KOSTT është udhëzuar për mënyrën e faturimit. Sipas kësaj shkrese, fatura për muajin Tetor nuk mund të kaloj vlerën prej 223,873.92 € dhe duke llogaritur humbjet për tetor të kalkuluar në vlerë prej 202,094.60 €, diferenca duhet të jetë 21,824.32 €”. Në vazhdim të shkresës theksohet se vendimi i Bordit të ZRRE-së nr. V_362_2011 i datës 14 prill 2011 nuk ka pasur për subjekt të hyrat e Lejuara për KOSTT-in e as vlerën e tyre, por Tarifat dhe Ngarkesat e Transmisionit që do të zbatohen nga data 1 prill 2011. Po ashtu KOSTT-i në shkresë ka theksuar se në qoftëse ZRRE vendos të aplikojë formën e Të Hyrave Tavan atëherë në bazë të Metodologjisë Tarifore dhe ligjeve të Energjisë nuk janë të licencuarit të thirrur të zbatojnë këtë formë, por ZRRE-ja. KOSTT në shkresë gjithashtu ka potencuar se Të Hyrat e Lejuara përfshijnë vitin tarifor i cili fillon nga 1 prilli i vitit aktual deri më 31 mars të vitit vijues dhe se nga kjo shihet se të Hyrat (faturimi) për muajt Janar, Shkurt, Mars janë bërë në bazë të tarifave të lejuara për vitin 2010.*

Provë: Shkresa e KOSTT dërguar KEK-ut me datë 17.11.2011

Me datë 24.11.2011 KOSTT i ka dërguar një shkresë ZRRE-së lidhur me faturat e ngarkesave të transmisionit për muajin tetor 2011. Në shkresë është theksuar se: *“Ashtu siç jeni të njoftuar përmes korrespondencave të KEK sha dhe KOSTT sha, KOSTT po përballet me vështirësi gjatë faturimit në fund të vitit. Këto vështirësi kanë të bëjnë me faturimet që bëhen nga ana e KOSTT sha për KEK sha përkitazi me shërbimet e kryera”. Me datë 21.11.2011 KEK-u i kthyer KOSTT-it në formë elektronike një deklaratë, në të cilën është theksuar se pro-faturat për muajin tetor 2011 janë të papranueshme. KOSTT në vazhdim të shkresës ka theksuar se kjo situatë e cila po vazhdon ka implikime negative për KOSTT-in si dhe ndikon direkt në raportime financiare dhe tatimore.*

Provë: Shkresa e KOSTT dërguar ZRRE-së me datë 24.11.2011

Me datë 12.12.2011 ZRRE i ka dërguar një shkresë KEK-ut lidhur me procedimin e faturave të KOSTT për KEK-un për ngarkesat e transmisionit. Në shkresë ZRRE e ka udhëzuar KEK-un që t'i paguajë KOSTT-it faturat për ngarkesat e transmisionit për muajin tetor 2011, duke i rikujtuar se të licencuarit në asnjë rrethanë nuk janë kompetent për të vendosur të Hyrat të cilësdo palë. Në vazhdim ZRRE ka theksuar se viti relevant tarifor përfshin periudhën prej 1 prillit të vitit aktual deri më 31 mars të vitit pasues (12 muaj) dhe se ndryshon nga viti fiskal.

Provë: Shkresa e ZRRE-së dërguar KEK-ut me datë 12.12.2011

Me datë 14.12.2011 KEK i ka dërguar KOSTT-it një shkresë lidhur me faturat e ngarkesave të transmisionit për muajin tetor 2011. Në këtë shkresë KEK-u ka përsëritur qëndrimin e shkresës paraprake duke refuzuar pagesën e faturave të cekura.

Provë: Shkresa e KEK-ut dërguar KOSTT-it me datë 14.12.2011



Me datë 20.01.2012 KEK-u i ka dërguar KOSTT-it një shkresë lidhur me kthimin e faturave për ngarkesat e Transmisionit për muajt nëntor dhe dhjetor 2011. Në këtë shkresë KEK-u ka përsëritur qëndrimin e shkresës paraprake duke refuzuar pagesën e faturave për muajt nëntor dhe dhjetor 2011.

Provë: Shkresa e KEK-ut dërguar KOSTT-it me datë 20.01.2012

Me datë 12.03.2012 KOSTT-i i ka dërguar ZRRE-së një shkresë lidhur me kthimin e faturave të transmisionit për muajt nëntor dhe dhjetor 2011. Në këtë shkresë është theksuar se me datë 29.02.2012 (shkresa e KEK-ut e datës 20.01.2012) KEK-u i ka dërguar KOSTT-it një shkresë lidhur me kthimin e faturave të transmisionit për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor 2011. Në vazhdim të kësaj shkrese është theksuar se KOSTT ka ngritur kontest në KEK për faturat e tetorit dhe nëntorit 2010 dhe për të cilën ZRRE ka vendosur në mbledhjen e mbajtur nga Bordi i ZRRE-së me datë 29.12.2011. Në vendimin e Bordit të ZRRE-së lidhur me kontestin e ngritur theksohet se KOSTT ka vepruar në pajtueshmëri të plotë me legjislacionin dhe rregullat në fuqi.

Provë: Shkresa e KOSTT e dërguar ZRRE-së me datë 12.03.2012

Me datë 29.05.2012 KEK-u i ka dërguar një shkresë ZRRE-së si kundërpërgjigje ndaj inicimit të kontestit të KOSTT-it, lidhur me refuzimin e pagesës për shërbimet e transmisionit dhe mospranimin e faturave për muajin tetor, nëntor dhe dhjetor të vitit 2011. Në shkresë është theksuar se KEK-u synon të paguajë KOSTT-in për shërbimet e transmisionit në përputhje me tarifën e aprovuar nga ZRRE, megjithatë nuk ka burime financiare për të paguar KOSTT-in për çdo shumë që tejkalon shumën e përfshirë në të hyrat e lejuara të KEK-ut, e të miratuara nga ZRRE për qëllime të mbulimit të tarifave të shitjes me pakicë. Sipas shkresës nëse KEK-u do të paguante KOSTT-in çfarëdo shume më tepër se shuma e përcaktuar që do të duhej të mbulohej nga konsumatorët, ajo do të përfaqësohej në mënyrë të qartë një subvencion nga një i licencuar (KEK) në një tjetër (KOSTT). Në vazhdim të shkresës theksohet se shuma prej 3,278,404€ (neto pa TVSH) e pretenduar nga KOSTT-i është 26% më shumë se të hyrat e lejuara prej € 12,542,000, të aprovuara nga ZRRE-ja në SHTE5 dhe se ky fakt duhet të ketë alarmuar ZRRE-në se tarifën e transmisionit nuk janë projektuar siç duhet për mbulimin e të hyrave të lejuara të përcaktuara nga ZRRE-ja. KEK-u në shkresë po ashtu ka theksuar se sipas rregullave të nxjerra kohëve të fundit për vendosjen e çmimeve të Furnizuesit Publik në nenin 9 dhe 14 ngarkesat e Operatorit të Tregut, Sistemit dhe ngarkesat për shfrytëzimin e sistemit (TNUOS) si "kosto kaluese" të cilat duhet plotësisht të kalojnë në përditësimet vjetore dhe se KEK-u pajtohet me këtë parim. Në shkresë KEK-u propozon dy zgjidhje: nëse ZRRE pranon të hyrat e realizuara të KOSTT-it të njëjtën vlerë duhet t'i kompenzojë KEK-ut dhe zgjidhja e dytë të anulohet kontesti.

Provë: Përgjigja e KEK-ut ndaj inicimit të kontestit të KOSTT-it në ZRRE me datë 29.05.2012.

Sipas të dhënave të prezantuara dhe të konfirmuara nga palët në fjalë, të gjitha faturat e KOSTT-it dërguar KEK-ut deri në shtator të vitit 2011, KEK-u i ka paguar, ndërsa kanë mbetur të pa paguara faturat për muajin, tetor, nëntor dhe dhjetor të vitit 2010 në vlerë prej 3,802,949€.

Provë: Gjendja e pagesave (faturat)

Kërkesa e KOSTT-it në kontestin e ngritur në ZRRE, është që:

- KEK-u t'i pranojë faturat e KOSTT-it faturat për periudhën, tetor, nëntor dhe dhjetor të vitit 2011, dhe të paguaj borxhin në vlerë 3,802,949€;
- KOSTT-i të bëjë pagesën KEK-ut për blerjen e energjisë sipas vlerës së energjisë së faturuar;
- KOSTT-it pas kalimit të afatit për pagesën e faturave sipas nenit 67 të Rregullave të Tregut, do të faturojë KEK-ut edhe kamatën ligjore vjetore prej 8/% në vlerën e borxhit.



Analiza e kontestit

Sipas Nenit 14, paragrafi 2 të **Ligjit për Rregullatorin e Energjisë**, ZRRE për përmbushjen e detyrave të veta, ka autoritetin dhe përgjegjësinë për hartimin/miratimin e metodologjive tarifore; të zgjidhë kontestet që kanë të bëjnë me çështjet e licencave të lëshuara nga ZRRE-ja ndërmjet konsumatorëve dhe ndërmarrjeve për energji, operatorëve të sistemit dhe ndërmarrjeve energjetike, si dhe ndërmjet dy ndërmarrjeve energjetike; si dhe të nxjerrë rregulla dhe vendime individuale.

Sipas nenit 43, paragrafi 1 të **Ligjit për Rregullatorin e Energjisë**, ZRRE miraton tarifat për shërbimet e rregulluara të energjisë bazuar në metodologjitë e tarifave për tarifat e rregulluara dhe në propozimet për rishikimin e tarifave të dorëzuara nga ndërmarrjet e energjisë.

Në nenin 17 të **Ligjit për Energjinë** përcaktohet se: *“të gjitha tarifat e rregulluara dhe metodologjitë tarifore duhet t'i mundësojnë ndërmarrjes së rregulluar të energjisë mundësinë që të ngarkojë me tarifa dhe të kthejë koston e arsyeshme të plotë vjetore për shërbime.*

Në paragrafin 4.11.1 të **Metodologjisë së Tarifave për Sektorin e Energjisë Elektrike** përcaktohet se *“vlera aktuale (VA) e të ardhurave të lejuara të OST-së duhet të barazohet me kostot e lejuara të përcaktuara. Sidoqoftë, nuk kërkohet që të ardhurat e lejuara dhe kostot e lejuara të jenë të barabarta gjatë çdo viti”.*

Në nenin 4.11.3 të **Metodologjisë tarifore për sektorin e energjisë elektrike** përcaktohet se *“kontrolli i çmimit të marrë formën e të ardhurave -“tavan”, ku vlera maksimale e të ardhurave të lejuara që do të rigjenerohet në secilin vit të periudhës së kontrollit të çmimit është fikse, pavarësisht nga vëllimet e transmetuara. Do të përdoret faktori korrigjues për rregullimin e dallimit në mes të të ardhurave aktuale të fituara, dhe nivelit të lejuar në vitin paraardhës.”*

Sipas nenit 65 të **Rregullave të Tregut**, Operatori i Tregut (OT) një herë në muaj dërgon faturat për Palët Tregtare dhe të tjerët, për shfrytëzimin e rrjetit të transmisionit, ku në këto fatura përfshihen të gjitha taksat e aplikueshme.

Në nenin 67 të **Rregullave të Tregut** përveç tjerash përcaktohet se: *“Palët Tregtare do të paguajnë të gjitha paratë në lidhje me një faturë (dhe OT do të paguaj të gjitha paratë borxh për Palët Tregtare) në Ditën e 7^{të} të Punës pas lëshuarjes së faturës. Po ashtu në këtë nen theksohet se: Reklamimet e Faturës mund të ngritën nga një Palë Tregtare. Nëse kjo ndodhë atëherë ata do të paguajnë shumën e pa kontestuar të Faturës dhe pjesa tjetër do të zgjidhet kur Reklamimi të zgjidhet. Pagesa e pakontestuar e faturës së kontestuar gjithashtu imponohet edhe në nenin 69 të **Rregullave të Tregut.***

ZRRE pas procesit të shqyrtimit të tarifave të energjisë elektrike me datë 14 prill 2011 ka aprovuar tarifat e energjisë elektrike për KOSTT-in dhe KEK-un. Të hyrat e lejuara për KOSTT-in kanë qenë 12,542,053€ ndërsa për KEK-un kanë qenë 180,382,712€.

ZRRE duke u bazuar në të hyrat e lejuara ka llogaritur çmimin mesatar me pakicë për konsumatorët në përgjithësi, si dhe tarifat për shfrytëzim të sistemit.

Në bazë të të hyrave të lejuara fitohet çmimi për njësi [€/MWh] për periudhën e shqyrtuar tarifore:

$$\text{Çmimi [€/MWh]} = \text{Vlera e të hyrave të lejuara [€]} / \text{Vëllimi i energjisë që transmetohet [MWh]}$$

Të hyrat e realizuara pastaj llogariten duke shumëzuar çmimin [€/MWh] dhe vëllimin e energjisë të transmetuar [MWh] në periudhën e shqyrtuar tarifore.



Sipas nenit 4.11.1 të Metodologjisë Tarifore për Sektorin e Energjisë Elektrike vlera e realizuar e të hyrave të lejuara për KOSTT-in duhet të barazohet me kostot e lejuara të përcaktuara nga ZRRE, mirëpo nuk kërkohet që të hyrat e lejuara dhe kostot e lejuara të jenë të barabarta gjatë çdo viti. Ndryshimi i mundshëm i cili paraqitet si rezultat i parashikimit jo të saktë të vëllimit të transmetuar të energjisë elektrike do të korrigjohet nëpërmjet bashkërenditjes në të hyrat e lejuara në vitin pasardhës dhe të cilën e ka kompetencë vetëm ZRRE-ja e jo të licencuarit.

Tarifat dhe ngarkesat e aprovuara të transmisionit do të zbatohen nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) duke filluar nga data 1 prill 2011. Sipas vendimit të ZRRE-së viti relevant tarifor përfshin periudhën prej 1 prillit të vitit aktual deri më 31 mars të vitit pasues (12 muaj) dhe ndryshon nga viti fiskal. Kjo periudhë përcaktohet përmes shqyrtimit tarifor. Në rast se të hyrat të cilësdo palë të ndryshojnë në masë të konsiderueshme nga të hyrat e lejuara, atëherë të licencuarit mund të kërkojnë nga ZRRE që të bëhet rishikimi i tarifave. Rishikimi i tarifave balancon tarifën për vitin tarifor në nivelin e Të Hyrave të Lejuara për të gjithë të licencuarit. Nëse një gjë e tillë nuk ndodh, atëherë në fund të vitit tarifor ZRRE do të bëjë bashkërenditjen përmes Llogarisë Balancuese të Tarifave (LBT).

Faturat që KOSTT-i i ka dërguar në KEK deri në periudhën tetor 2011 përfshijnë periudhën shtatë mujore (prill – tetor). Llogaritja e Të Hyrave të paraqitura nga KEK-u për periudhën nga janari deri në dhjetor është e gabuar dhe nuk paraqet vlerën reale rreth Të Hyrave të Lejuara për KOSTT për vitin tarifor aktual, ngase përfshijnë tre (3) muaj nga periudha e tarifave nga shqyrtimi i kaluar tarifor.

Sipas **Ligjit për Rregullatorin e Energjisë**, ZRRE është institucioni i vetëm i cili ka autoritetin të miratoj tarifa për shërbimet e rregulluara të energjisë, prej nga rrjedh se ndërmarrjet energjetike (në këtë rast KOSTT dhe KEK) nuk janë kompetente për të vlerësuar kufirin e të hyrave të realizuara, të cilës do palë, e në rastin konkret KEK/Furnizimi nuk ka të drejtë të vendosë për të hyrat e lejuara për KOSTT-in. Të licencuarit mund të iniciojnë rishikimin e tarifave në ZRRE nëse mendojnë se tarifën e përcaktuar në bazë të vëllimit të parashikuar nuk i reflektojnë të hyrat e lejuara për cilëndo palë, gjë të cilën palët nuk e kanë inicuar.

Rregullat e reja për vendosjen e çmimeve si ajo e Furnizuesit Publik të Energjisë Elektrike (Rregulla për çmimet FPPE) e OSSH-së, OST-së dhe Gjenerimit janë rregulla të cilat janë aprovuar nga Bordi i ZRRE-së me datë 30.09.2011. Rregullat e reja për vendosjen e çmimeve e të aprovuara nga Bordi i ZRRE-së janë rregulla të cilat do të përdoren për shqyrtimin e ardhshëm tarifor dhe se nuk kanë të bëjnë me periudhën për të cilën ka të bëjë kontesti në fjalë.

ZRRE në shqyrtimin e ardhshëm tarifor do të bëjë bashkërendimin e pjesës së të hyrave mbi vlerën e lejuar të KOSTT-it, e cila kap vlerën prej 3,802,949€. Nëpërmjet këtij bashkërendimi KOSTT-it do t'i zbriten pjesa e të hyrave mbi vlerën e lejuar dhe me këtë rast do të përfitojnë konsumatorët.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 18.07.2012 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga palët në kontest, andaj konform dispozitave ligjore që janë në fuqi merr vendim me të cilën aprovon kontestin e ngritur nga KOSTT-i të cekur si në dispozitivin e këtij vendimi.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtar

Krenar Bujupi, anëtar